

**BROSHURË
INFORMUESE
PËR PLANIN
E INTEGRUAR
TË
VEPRIMIT
PËR
TRASHËGIMINË
DISONANTE
NË
PËRMET**

URBACT



Co-funded by
the European Union
Interreg

ARCHETHICS

HYRJE

Plani i Integruar i Veprimit (IAP) është hartuar si pjesë e projektit **ARCHETHICS**, i financuar nga programi i Bashkimit Evropian **URBACT IV**.

Qëllimi i projektit ARCHETHICS është të zhvillojë politika të qëndrueshme për qytetin, duke përdorur trashëgiminë disonante si mjet për të bashkuar komunitetin, për të krijuar identitete të reja demokratike dhe për të nxitur menaxhimin e qëndrueshëm të saj. Projekti ofron mundësi për zhvillim kulturor dhe turistik, duke lidhur trashëgiminë me arkitekturën, kujtesën kolektive dhe vetëdijen shoqërore. Kjo qasje mbështetet mbi katër shtylla kryesore: **Arkitektura, Njerëzit, Historia dhe Etika**, duke e shndërruar trashëgiminë disonante në pikënisje për një qytet më të hapur, të ndërgjegjshëm dhe të bashkuar.

Kjo broshurë paraqet një përmbledhje të Planit të Integruar të Veprimit, i cili është hartuar nga Bashkia Përmet në bashkëpunim me grupet e interesit. Ajo sjell informacionet kryesore të planit, duke u fokusuar tek logjika e ndërhyrjes, vizioni, objektivat dhe veprimet kryesore. Çdo veprim është i detajuar duke përcaktuar hapat e zbatimit, grupet e synuara, koston dhe periudhën e realizimit. Në përfundim, broshura evidenton faktorët kryesorë që garantojnë suksesin e zbatimit të planit, duke ofruar një pamje të qartë mbi elementët e domosdoshëm për realizimin efektiv të veprimeve të propozuara.

PËRKUFIZIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE

Historia e Evropës ka krijuar një trashëgimi që shpesh është e debatueshme dhe komplekse, për shkak të lidhjes së saj me regjime totalitare ose me kufij të kontestuar. Kjo trashëgimi quhet “trashëgimi disonante”, duke iu referuar marrëdhënies problematike ndërmjet elementeve fizike – si arkitektura, lagjet, monumentet dhe hapësirat publike urbane – dhe vlerave historike e politike që ato përfaqësojnë.

Në kontekstin e projektit ARCHETHICS, trashëgimia disonante kuptohet si trashëgimia arkitekturore dhe kulturore që ngjall kujtime të pakëndshme, për shkak të luftërave, propagandës së regjimeve totalitare ose kufijve të diskutueshëm të përjetuar nga shoqëria. Ajo lidhet ngushtë me elementet fizike – ndërtesa, rrugë, sheshe – dhe me kontekstin historik, politik dhe vlerat që i kanë prodhuar në të kaluarën.

Trashëgimia disonante e studiuar nga ARCHETHICS shpesh është e heshtur, e padukshme dhe e panjohur nga komuniteti. Për këtë arsye, projekti propozon një qasje shumëperspektivëshe, e cila synon të rishkruajë dhe të rilexojë historinë, të mbledhë dëshmi dhe të nxisë nismat pjesëmarrëse për vlerësimin dhe interpretimin e kësaj trashëgimie.

KATËR DIMENSIONET E TRASHËGIMISË DISONANTE

ARKITEKTURA përfaqëson ndërtesat dhe monumentet e së kaluarës disonante, ndërtuar për qëllime ideologjike, ushtarake ose propagandistike. Synimi është t'i ruajmë dhe adaptojmë këto objekte përmes ndërhyrjeve fizike dhe përdorimit të teknologjive digjitale, duke i bërë më të aksesueshme.



NJERËZIT janë thelbësorë për riinterpretimin e trashëgimisë disonante. Planit është hartuar duke angazhuar të gjitha grupet e interesit — të rinj, të moshuar, mësues, historianë, operatorë turistikë, organizata joqeveritare dhe zyrtarë publikë— duke siguruar përfshirjen e perspektivave të ndryshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përfshirjes sipas moshës, gjinisë dhe grupeve sociale.



HISTORIA trajton marrëdhënien komplekse midis kujtesës institucionale dhe asaj personale. Trashëgimia disonante e Përmetit pasqyron periudha të vështira, si komunizmi dhe pushtimi italian, duke lënë trashëgimi fizike dhe emocionale. Planit synon të zbulojë dhe dokumentojë të vërtetat e pakëndshme, stigmat dhe historitë e heshtura përmes arkivave të digjitalizuara, programeve edukuese dhe dialogut komunitar. Kjoqasje nuk lartëson as nuk fshin të kaluarën, por nxit angazhimin kritik që pranon kompleksitetin dhe mbështet reflektimin e informuar.



ETIKA udhëheq riinterpretimin e trashëgimisë disonante përmes vlerave të përbashkëta pozitive, si demokracia, përfshirja dhe respekti kulturor. Planit inkurajon interpretimin kritik të këtyre vendeve, duke i transformuar ato nga simbole të ndarjes në platforma për edukim qytetar dhe kohezion kulturor. Angazhimi etik siguron që narrativat të jenë të sakta, të balancuara dhe gjithëpërfshirëse, duke fuqizuar komunitetin për të reflektuar mbi historinë e tij në mënyra që promovojnë bashkimin, edukimin dhe identitetin kolektiv.



TRASHËGIMIA DISONANTE NË PËRMET

Trashëgimia disonante në Përmet i referohet trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore kontroverse që vjen nga periudha komuniste(1944-1991) dhe pushtimi italian (1939-1943). Kjo trashëgimi përfshin ndërtesa, monumente dhe objekte të ndryshme historike, të ndërtuara ose krijuara për të pasqyruar një kornizë të caktuar politike dhe ideologjike. Sot, ato mbeten në qendër të debatit mbi rëndësinë e tyre historike dhe rolin që luajnë në shoqërinë bashkëkohore.

Ndër strukturat më të rëndësishme është ndërtesa ku u mbajt Kongresi i Përmetit. Kjo ndërtesë historike shërbeu si vendtakim më 24 maj 1944, kuudhëheqësit komunistë shqiptarë u mbledhën me 188 delegatë nga e gjithë Shqipëria për të hapur Kongresin. Përmeti u zgjodh për këtë takim vendimtar sepse ishte qyteti i parë i çliruar, kishte një pozicion gjeografik strategjikisht të favorshëm dhe ishte vendlindja e disa udhëheqësve të shquar të Rilindjes Kombëtare.

Vendimi më i rëndësishëm i Kongresit ishte angazhimi për ndërtimin e një Shqipërie të re, demokratike dhe të orientuar nga populli. Pas rënies së komunizmit, për shkak të lidhjes së tij me fillimin e regjimit komunist, ndërtesa u neglizhua dhe u degradua.

Ndodhet brenda qytetit të Përmetit dhe u ndërtua midis viteve 1938 dhe 1940 nga ushtria italiane, duke shërbyer si kazermë ushtarake deri në vitin 1944. Sot, në një nga dhomat e ndërtesës ndodhet muzeu i luftës, që ka rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve. Ka statusin e Monumentit Kulturor të Kategorisë së Parë

Foto nga Mbledhja e Kongresit



Muzeu i Luftës

SITE TË TJERA TË TRASHËGIMISË DISONANTE

REZIDENCA E OFICERËVE

Është një ndërtesë që gjatë periudhës komuniste shërbente si rezidencë për oficerët. Ajo u shkatërrua në vitin 1997 dhe u rindërtua në vitin 2012 për të funksionuar si një qendër kulturore, me ekspozita muzeale, sallë konferencash, sallë ekspozitash dhe gjithashtu si pikë informacioni për turistët. Ndërtesa sot quhet "Qendra Multifunksionale Kulturore Odhise Paskali".



KINEMAJA "13 SHTATORI"

Ndërtesa shërbente si kinema gjatë regjimit komunist dhe u rinovua në vitin 2022. Sot, ajo vazhdon të funksionojë si kinema dhe gjithashtu shërben si qendër për aktivitete kulturore



**BUNKERE, TUNELE,
MONUMENTE**



**RRËNOJAT E KAZERMËS
ITALIANE**

PJESËMARRJA E AKTORËVE LOKALË NË PLANIFIKIM

Qasja pjesëmarrëse është një parim themelor i programit URBACT dhe i këtij Plani të Integruar të Veprimit (IAP). Përfshirja e aktorëve të duhur që nga fillimi është thelbësore për krijimin e një plani praktik dhe efektiv. Hapi i parë ishte identifikimi i aktorëve kryesorë, ndërsa hapi i dytë ishte angazhimi i tyre aktiv për të adresuar sfidat që paraqet trashëgimia disonante në Përmet. Ky angazhim u realizua përmes krijimit të **Grupit Lokal të Veprimit URBACT (ULG)** dhe emërimit të një koordinatori të përshtatshëm për menaxhimin e tij. Grupi ULG është një komponent thelbësor i programit URBACT. Çdo qytet partner në një projekt URBACT duhet të krijojë një ULG për të bashkuar të gjithë aktorët lokalë të lidhur me temën e adresuar.

Grupi ynë ULG përbëhet nga 18 anëtarë. Ata mbajtën takime për të identifikuar sfidat kryesore që trashëgimia disonante në Përmetpërballet, për të krijuar një vizion të përbashkët dhe për të detajuar veprimet që do të ndërmerren për t'i adresuar këto sfida.

Departamentet e Bashkisë

- Edukimi
- Shërbime sociale
- Turizmi dhe trashëgimia kulturore
- Planifikimi urban
- Projektet me donatorë të huaj

Organizatat e shoqërisë civile

- CESVI
- VJOSA EXPLORER


- Mësues historie të shkollës "Nonda Bulka " dhe "Sejfulla Malshova"
- Historianë lokal

- Këshilli Rinor Vendor
- Guida turistike lokale
- Anëtarë të komunitetit
- Mosha e tretë

IDENTIFIKIMI I PROBLEMATIKAVE


PAVARËSISHT POTENCIALIT TË TYRE TË KONSIDERUESHËM TURISTIK, VENDET E TRASHËGIMISË DISONANTE ENDE NUK JANË SHNDËRRUAR NË DESTINACIONE TURISTIKE TË NJOHURA.

Vendet e trashëgimisë disonante në Përmet përballen me disa sfida që kufizojnë potencialin e tyre si destinacione turistike. Shumë prej tyre mbeten të pa rikonstruktura ose mirëmbahen në mënyrë të pamjaftueshme, gjë që rezulton në akses të kufizuar dhe përvoja të dobëta për vizitorët. Mungesa e sinjalistikës informuese dhe e informacionit të detajuar historik lë vizitorët potencialë të pa informuar mbi rëndësinë kulturore të këtyre vendeve. Për më tepër, promovimi i pamjaftueshëm nga operatorët turistikë dhe autoritetet lokale redukton dukshmërinë e tyre në një treg konkurrues. Së fundi, këto vende shpesh nuk përfshihen në planet strategjike për turizmin dhe zhvillimin urban, duke çuar në investime të kufizuara dhe përpjekje të pamjaftueshme të koordinuara për ruajtjen e tyre.




TRASHËGIMIA DISONANTE PËRDORËT PAK OSE ASPAK PËR QËLLIME EDUKUESE DHE KULTURORE.

Pavarësisht se ofrojnë një pasqyrë unike të së kaluarës, këto vende nuk ofrojnë programe apo aktivitete të mjaftueshme për të ndihmuar njerëzit të lidhen me këtë pjesë të historisë. Shumë shkolla i vizitojnë rrallë ose nuk përdorin materialet e disponueshme, ndërsa shumë dokumente dhe objekte historike nuk janë ruajtur mirë dhe mbeten të vështira për t'u aksesuar, pasi ekzistojnë vetëm në formë fizike dhe jo digjitale. Me kalimin e kohës, ruajtja e këtyre burimeve do të bëhet edhe më sfiduese. Gjithashtu, aktivitete të lidhura me trashëgiminë disonante organizohen shumë pak nga bashkia ose aktorë të tjerë.



VIZIONI I PLANIT



VENDET E TRASHËGIMISË DISONANTE NË PËRMET TË SHNDËRROHEN NË DESTINACIONE TË PREFERUARA TURISTIKE DHE NË VENDE ME VLERA TË LARTA EDUKUESE DHE SOCIO-KULTURORE.

Për t'u përballur me dy problemet kryesore të identifikuar më sipër, vizioni ynë i përbashkët për vendet e trashëgimisë disonante është t'i transformojmë ato në destinacione turistike të qëndrueshme dhe qendra me vlerë edukuese dhe socio-kulturore. Kjo përputhet me vizionin e zhvillimit të Bashkisë Përmet, i cili prioritetizojnë identifikimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së pasur të qytetit, duke kontribuar në rritje ekonomike afatgjatë dhe mirëqenie për qytetarët.

Për ti kthyer vendet e trashëgimit disonante në destinacione turistike, duhet të investojmë së pari në përmirësimin e infrastrukturës fizike për të lehtësuar aksesueshmërinë dhe më pas t'i integrojmë ato në ofertat turistike të Përmetit. Bashkëpunimi me operatorët turistikë, bizneset lokale dhe aktorët e tjerë që përfitojnë nga turizmi është thelbësor për sukses afatgjatë. Kjo qasje krijon një model të qëndrueshëm që rrit dukshmërinë e tyre dhe njëkohësisht nxit rritjen ekonomike lokale.

Integrimi i suksesshëm i trashëgimisë disonante në strategjinë turistike të Bashkisë Përmet do të rrisë jo vetëm ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e këtyre vendeve, por gjithashtu do të gjenerojë përfitime ekonomike afatgjata për komunitetin. Trashëgimia disonante mund të shërbejë si një mjet i fuqishëm për edukim dhe turizëm. Vizitat turistike, ekspozitat dhe aktivitetet komunitare që theksojnë rëndësinë historike dhe trashëgiminë komplekse të këtyre vendeve mund t'i ndihmojnë vendasit dhe vizitorët të kuptojnë historinë shumëdimensionale të Përmetit. Të tilla iniciativa mund të kthejnë këto vende në pikënisje të diskutimeve mbi demokracinë, identitetin dhe zhvillimin.

Bazuar në këtë logjikë janë formuluar objektivat e planit dhe veprimet specifike.

LOGJIK A E PLANIT

Objektivi strategjik 1: Transformimi i vendeve të trashëgimisë disonante në destinacione turistike të qëndrueshme.
Objektivi specifik 1.1: Lehtësimi i aksesit në vendet e trashëgimisë disonante.
VEPRIMET:

Veprimi 1: Dizajni dhe vendosja e sinjalistikës informuese në vendet kryesore të trashëgimisë disonante.
 Veprimi 2: Përmirësimi i kushteve fizike të vendeve të trashëgimisë disonante.
 Veprimi 3: Lehtësimi i aksesit në vendet e trashëgimisë disonante përmes përdorimit të teknologjive digjitale interaktive.

Objektivi specifik 1.2: Përfshirja e këtyre vendeve në ofertën turistike të Përmetit.
VEPRIMET:

Veprimi 4: Integrimi i trashëgimisë disonante në ofertën turistike të Bashkisë së Përmetit.
 Veprimi 5: Bashkëpunimi me operatorët turistikë për përfshirjen e trashëgimisë disonante në paketat e tyre turistike.

Objektivi strategjik 2: Rritja e ndërgjegjësimit për vlerën dhe potencialin e trashëgimisë disonante duke e përdorur për qëllime edukuese dhe socio-kulturore.
Objektivi specifik 2.1: Inkurajimi i përdorimit më të mirë të potencialit të trashëgimisë disonante për qëllime edukuese.
VEPRIMET:

Veprimi 6: Krijimi i arkivit digjital të trashëgimisë disonante.
 Veprimi 7: Përdorimi i trashëgimisë disonante për aktivitete edukuese.
 Veprimi 8: Të mësojmë se si qytetet e tjera evropiane trajtojnë trashëgiminë disonante.

Objektivi specifik 2.2: Integrimi i trashëgimisë disonante në jetën socio-kulturore të Bashkisë.
VEPRIMET:

Veprimi 9: Përdorimi multifunksional i vendeve të trashëgimisë disonante.
 Veprimi 10: Organizimi i aktiviteteve kulturore për trashëgiminë disonante.

LOGJIKË E PLANIT

VEPRIMI 1: DIZAJNI DHE VENDOSJA E SINJALISTIKËS INFORMUESE NË VENDET KRYESORE TË TRASHËGIMISË DISONANTE

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Identifikimi	Hapi i parë është identifikimi i vendeve kryesore për vendosjen e tabelave, duke u bazuar në interesin e vizitorëve dhe rëndësinë historike. Trashëgimia disonante i referohet vendeve të lidhura me të kaluarën e dhimbshme ose të kontestuar të regjimit komunist; prandaj, është shumë e rëndësishme përfshirja e grupeve të interesit gjatë fazës së identifikimit dhe vlerësimit të vendeve.	2026	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Dizajni i tabelave	Do hartohet tekst historikisht i saktë dhe neutral, i shoqëruar me elemente vizuale dhe kode QR. Tabelat do të jenë dygjuhëshe, me Braille, akses për personat me aftësi të kufizuara, të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin. Konsultimet me historianë, ekspertë të trashëgimisë dhe komunitete lokale do të sigurojnë një përmbajtje të saktë dhe neutrale.	2026	Kosto e dizanjit, printimit dhe intallimit të tre tabelave informuese – 4,000 euro. Burimi i financimit: Bashkia Përmet
Vendosja tabelave	Tabelat do të vendosen në vende të dukshme dhe të aksesueshme dhe me ndikim minimal mbi mjedisin.	2026	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Mirëmbajtja	Bashkia do jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e tyre për të parandaluar dëmtimin nga moti dhe zbehjen e teksteve.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Targeti: Numri i tabelave informuese të installuara në vendet e trashëgimisë disonante: Të paktën 3 brënda 2026.

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 2: PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE FIZIKE TË VENDEVE TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Mirëmbajtja e vazhdueshme e vendeve të trashëgimisë disonante	Përprojekjet e mirëmbajtjes do të përqendrohen fillimisht tek 5 vende të trashëgimisë disonante. Disa prej tyre janë monumente të mbrojtura kulturore, prandaj është e nevojshme të ketë koordinim me institucionet përgjegjëse. Përprojekjet e mirëmbajtjes do të përfshijnë pastrim rutinë brenda dhe rreth këtyre vendeve, mirëmbajtjen e rrugëve dhe shtigjeve që çojnë tek vendet dhe identifikimin e gjendjes së tyre.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Ndërhyrje strukturore në shkallë të vogël	Këto përprojekte përfshijnë riparime të vogla si korrigjimi i çarjeve, restaurimi i fasadave dhe forcimi i strukturave të dobëta duke përdorur teknika që respektojnë ruajtjen e tyre. Për të siguruar autenticitetin dhe efektivitetin, specialistët e konservimit do të mbikëqyrin këto ndërhyrje, duke mbështetur ruajtjen afatgjatë dhe angazhimin e publikut.	2026	Kosto: afërsisht 8,000 euro në vit Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ose fonde të donatorëve të huaj
Kërkimi i mbështetjes për ndërhyrje në shkallë të madhe	Bashkia e Përmetit nuk ka fondet e nevojshme për ndërhyrje madhore në vendet e trashëgimisë disonante. Për të adresuar këtë, departamenti i projektimit dhe planifikimit urban do të kërkojë mbështetje nga ministritë përkatëse dhe do të aplikojë për projekte që financojnë ndërhyrje të tilla në këto vende.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Targeti:

Numri i vendeve të trashëgimisë disonante që mirëmbahen rregullisht: Të paktën 5

Numri i vendeve të trashëgimisë disonante ku janë kryer ndërhyrje të vogla: Të paktën 3 brenda vitit 2028

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 3: LEHTËSIMI I AKSESIT NË VENDET E TRASHËGIMISË DISONANTE PËRMES PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJIVE DIGJITALE INTERAKTIVE.

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Përdorimi i Realitetit Virtual (VR) dhe Augmented reality (AR)	Zhvillimi i aplikacioneve VR dhe AR që simulojnë vizita në vendet e trashëgimisë disonante, do u mundësojnë vizitorëve të përjetojnë një udhëtim realist në vende që janë shumë larg ose të vështira për t'u aksesuar. Kjo është e nevojshme për të mundësuar eksplorimin interaktiv të vendeve të trashëgimisë disonante, veçanërisht të vendeve që janë fizikisht të paarrtshme ose të rrezikshme për tu vizituar për shkak të gjendjes fizike aktuale të tyre.	2026-2028	Kosto: 40,000 euro Burimi i financimit: Projekte të Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+, etj.) + fonde të tjera të donatorëve.
Krijimi i fotografive 360°, HD dhe 3D	Aplikacionet VR dhe AR mund të jenë shumë të kushtueshme, prandaj për disa vende mund të fillojmë me bërjen e fotografive me cilësi të lartë. Këto foto mund të përdoren për të krijuar galeri interaktive ose muze virtuale të aksesueshëm për publikun përmes faqeve të internetit ose aplikacioneve mobile.	2025-2027	Kosto: 20,000 euro Burimi i financimit: Projekte të Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+, etj.) + fonde të tjera të donatorëve.
Promovimi	Përmbajtja duhet të jetë e aksesueshme në disa gjuhë për të arritur një audiencë sa më të gjerë. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare dhe promovimi i vazhdueshëm do të tërheqë vëmendjen ndërkombëtare ndaj vendeve të trashëgimisë disonante.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Targeti: Numri i vendeve të trashëgimisë disonante të aksesueshme përmes teknologjive digjitale interaktive: Të paktën 2 brenda vitit 2028.

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 4: INTEGRIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE NË OFERTËN TURISTIKE TË BASHKISË PËRMET.

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Përfshirja e trashëgimisë disonante në Planin Strategjik Lokal të Turizmit	Bashkia e Përmetit do të përfundojë Planin Strategjik Lokal të Turizmit në vitin 2025, dhe në këtë strategji do të përfshihen këto vende të trashëgimisë disonante dhe veprimet e propozuara në plan. Kjo do të ndihmojë që këto vende të njihen si asete kryesore kulturore dhe historike me potencial të lartë turistik, duke e bërë më të lehtë sigurimin e fondeve dhe mbështetjes për ruajtjen, promovimin dhe aksesueshmërinë e tyre.	2025	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Përfshirja e vendeve të trashëgimisë disonante në të gjitha materialet promovuese të Bashkisë	Integrimi i vendeve të trashëgimisë disonante në materialet promovuese të Bashkisë së Përmetit është thelbësor për rritjen e dukshmërisë së tyre. Kjo përfshin përditësimin e broshurave, faqeve të internetit dhe platformave digjitale, si dhe promovimin aktiv të këtyre vendeve përmes portaleve të turizmit online, mediave sociale dhe fushatave të synuara. Kjo qasje do të rrisë njohjen e tyre, duke tërhequr më shumë vizitorë dhe duke përmirësuar statusin e tyre si atraksione kulturore dhe historike. Aktualisht, vetëm Salla e Kongresit është përfshirë në materialet promovuese.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Përgatitja e materialeve specifike promovuese për trashëgiminë disonante	Kjo përfshin krijimin e broshurave, fletëpalosjeve dhe materialeve të printuara informuese, së bashku me video të shkurtra dhe dokumentarë që përfshijnë ekspertë lokalë. Për të arritur një audiencë më të gjerë, të gjitha materialet do të jenë të disponueshme në disa gjuhë, duke promovuar trashëgiminë disonante si pjesë thelbësore e turizmit kulturor të rajonit.	2026-2027	Kosto: 15,000 euro (përgatitja e videove, materialeve të printuara dhe digjitale) Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit dhe fonde të donatorëve kombëtarë dhe të huaj

Targeti:

Numri i vendeve të trashëgimisë disonante të përfshira në materialet promovuese: Të paktën 3 brenda vitit 2026

Numri i materialeve promovuese specifike të përgatitura për vendet e trashëgimisë disonante: Të paktën 10 brenda vitit 2027

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 5: BASHKËPUNIMI ME OPERATORËT TURISTIKË PËR PËRFSHIRJEN E TRASHËGIMISË DISONANTE NË PAKETAT E TYRE TURISTIKE.

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Promovimi i potencialit turistik të trashëgimisë disonante gjatë takimeve me operatorët turistikë	Bashkia e Përmetit organizon takime periodike me operatorët turistikë në nivele të ndryshme, pasi turizmi është një nga sektorët kyç të zhvillimit. Gjatë këtyre takimeve do të theksojmë potencialin e trashëgimisë disonante si një aset unik turistik, duke nënvizuar se do t'i mbështesim nëse përfshijnë këto vende në ofertat e tyre turistike. Fillimisht do të promovohen vendet që janë lehtësisht të aksesueshme për vizitorët dhe ato për të cilat kemi informacion të plotë.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Organizimi i vizitave në vendet e trashëgimisë disonante	Vizitat synojnë të ofrojnë një përvojë direkte për operatorët turistikë, gazetarët, bloggerët dhe influencerat, duke u njohur me rëndësinë kulturore dhe historike të këtyre vendeve. Të udhëhequra nga guida, këto vizita do të rrisin nivelin e informimit, do të nxisin përfshirjen në ofertat turistike dhe do të gjenerojnë rekomandime pozitive për promovim të mëtejshëm, duke përforcuar interesin dhe angazhimin e vizitorëve.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Mbështetja e operatorëve turistikë që përfshijnë vendet e trashëgimisë disonante në paketat e tyre turistike	Qëllimi i këtij hapi është të inkurajojë dhe lehtësojë përfshirjen e këtyre vendeve në ofertat e tyre turistike, duke ofruar stimuj dhe mbështetje logjistike. Për këtë do të ofrohen materiale promovuese falas, hyrje e lirë ose me çmim të reduktuar. Për më tepër, do të krijohen partneritete me bizneset lokale, përfshirë hotele dhe restorante, për të ofruar paketa të kombinuara që përmirësojnë përvojën e përgjithshme turistike, duke e bërë më tërheqëse për operatorët përfshirjen e këtyre vendeve në paketat e tyre.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Targeti:

Numri i vendeve të trashëgimisë disonante të përfshira në materialet promovuese: Të paktën 3 brenda vitit 2026

Numri i materialeve promovuese specifike të përgatitura për vendet e trashëgimisë disonante: Të paktën 10 brenda vitit 2027

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 6: KRIJIMI I ARKIVIT DIGJITAL TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Vlerësimi dhe Inventarizimi i Dokumenteve Ekzistuese	Ky hap përfshin një hulumtim të plotë të të gjitha materialeve fizike lidhur me trashëgiminë disonante. Ai përfshin identifikimin e dokumenteve ekzistuese, librave, dorëshkrimeve, fotografive dhe materialeve të tjera të rëndësishme që do të digjitalizohen.	Muaji 1-3	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Procesi i Digjitalizimit	Iniciativa e digjitalizimit do të përqendrohet fillimisht në katër kategori kryesore dokumentesh: revista "24 Maji", e cila ofron njohuri historike mbi periudhën e komunizmit; regjistrime të historisë së fshatrave, duke dokumentuar trashëgiminë lokale dhe zhvillimin kulturor; fotografi të lidhura me Kongresin e Përmetit, që kapin momente historike të rëndësishme; dhe biografi të figurave kyçe, duke ruajtur historitë e individëve të rëndësishëm.	Muaji 3-10	Eksperti IT: 10,000 euro Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit dhe fonde të donatorëve kombëtarë dhe të huaj
Promovimi	Kjo përfshin shpërndarjen dhe sigurimin e aksesit të materialeve për studiues, institucione arsimore, historianë dhe individë të interesuar. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të inkurajuar përdorimin, do të nisë një fushatë promovuese që përfshin informim përmes email-it, angazhim në rrjetet sociale dhe takime të veçanta me studiues, organizata kulturore dhe institucione arsimore. Bashkëpunimi me shkollat dhe universitetet do të ndihmojë gjithashtu në integrimin e materialeve në kurrikulat akademike përmes trajnimeve dhe leksioneve duke nxitur angazhimin edukativ.	Muaji 10-18	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Përditësime të Vazhdueshme	Arkivi do të përditësohet vazhdimisht me materialet e reja të digjitalizuara dhe do të mirëmbahet në mënyrë të qëndrueshme për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për përdoruesit, duke e bërë atë një burim të vlefshëm në vazhdimësi.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Targeti:

Numri i kategorive të dokumenteve të digjitalizuara: Të paktën 4 kategori brenda vitit 2025

Numri i shkollave ose universiteteve që përdorin arkivin: Të paktën 4 shkolla brenda vitit 2026

Numri i përdoruesve që aksesojnë arkivin: Të paktën 30 përdorues çdo vit

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 7: PËRDORIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE PËR AKTIVITETE EDUKUESE.

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Organizimi i vizitave në vendet e trashëgimisë disonante	Studentët do të kenë mundësi të ndërveprojnë drejtpërdrejt me këto vende dhe të mësojnë mbi rëndësinë e tyre historike. Këto vizita studimore do të udhëhiqen nga ekspertë të Bashkisë dhe profesorë, të cilët do të sigurojnë informacion të saktë.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Organizimi i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit mbi trashëgiminë disonante	Përveç vizitave, do të organizohen një sërë aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit, si tryeza të rrumbullakëta, trajnime dhe madje edhe flashmob-e, në bashkëpunim me shoqata, institucione arsimore dhe partnerë të tjerë. Këto iniciativa jo vetëm që do të rrisin ndërgjegjësimin, por gjithashtu do të përfshijnë aktivisht komunitetin në diskutime mbi narrativat historike dhe rolin e trashëgimisë disonante.	Vazhdimësi	Kosto: 6,000 euro në vit (shpenzime logjistike + ekspertë) Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit + projekte të Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+ etj.) + fonde të tjera të donatorëve
Organizimi i aktiviteteve inovative dhe angazhuese për të rinjtë dhe mësuesit	Mund të implementohen qasje kreative të ndryshme, si trajnime interaktive ku të rinjtë krijojnë përmbajtje digjitale, si podkaste, video ose art digjital, bazuar në konceptin e tyre mbi trashëgiminë disonante; konkurse; aktivitete artistike dhe sfida kreative që nxisin të rinjtë të zhvillojnë zgjidhje inovative për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë disonante, duke inkurajuar mendimin kritik. Është e rëndësishme të angazhohen edhe mësuesit, në mënyrë që ata të mund të përsërisin këto aktivitete vetë në të ardhmen.	Vazhdimësi	Kosto: 6,000 euro në vit (shpenzime logjistike + ekspertë) Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit + projekte të Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+ etj.) + fonde të tjera të donatorëve

Targeti:

Numri i studentëve që marrin pjesë në aktivitetet edukuese: të paktën 100 çdo vit

Numri i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit të organizuara: të paktën 2 çdo vit

Numri i ngjarjeve inovative për të rinjtë të organizuara: të paktën 1 çdo vit

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 8: TË MËSOJMË SE SI QYTETET E TJERA EVROPIANE TRAJTOJNË TRASHËGIMINË DISONANTE.

Hapat	Përshkrimi	Periodha	Kosto dhe burimi i financimit
Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare që fokusohen në trashëgiminë disonante	Për të forcuar përpjekjet në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë disonante, Bashkia do të kërkojë anëtarësim në organizata ndërkombëtare të dedikuara këtij qëllimi. Synimi është të bëhet anëtare e ATRIUM (The Architecture of Totalitarian Regimes of the 20th Century in Central and Eastern Europe), një organizatë që punon për ruajtjen dhe interpretimin e trashëgimisë disonante.	Vazhdimësi	Kosto: 830 euro – tarifë vjetore anëtarësimi në ATRIUM Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit
Pjesëmarrja në Projekte që fokusohen në trashëgiminë disonante	Përveç kësaj, Bashkia do të prioritetizojë aplikimet në projekte ndërkombëtare që synojnë veçanërisht trashëgiminë disonante. Këto projekte mund të përfshijnë konservim, interpretim dhe ripërdorim adaptiv të ndërtesave dhe monumenteve të kontestuara, duke kontribuar në kuptimin më të thellë dhe ripërdorimin e këtyre vendeve. Përmes angazhimit në iniciativa të tilla, Bashkia mund të ketë akses në burime, ekspertizë dhe financim për të avancuar misionin e saj për integrimin e trashëgimisë disonante.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Pjesëmarrja e grupeve të interesit dhe stafit të Bashkisë në aktivitete ndërkombëtare që lidhen me trashëgiminë disonante.	Përfshirja e grupeve të interesit dhe stafit në aktivitete ndërkombëtare, si konferenca dhe trajnime, do t'u mundësojë atyre të mësojnë nga përvojat e qyteteve të tjera evropiane. Duke u angazhuar në këto aktivitete, bashkia mund të adoptojë praktikën më të mira dhe të ndajë njohuritë e saj, duke forcuar kështu qasjen e saj ndaj trashëgimisë disonante.	Vazhdimësi	Kosto: 4,000 euro në vit (shpenzime udhëtimi dhe akomodimi) Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit + buxheti i projektit

Targeti:

Numri i organizatave ndërkombëtare ku është bërë anëtarësimi: të paktën 1

Numri i stafit dhe grupeve të interesit që marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare: të paktën 6 persona çdo vit

Numri i aplikimeve për projekte që fokusohen në trashëgiminë disonante: të paktën 1 aplikim çdo vit

LOGJIKË E PLANIT

VEPRIMI 9: PËRDORIMI MULTIFUNKSIONAL I VENDEVE TË TRASHËGIMISË DISONANTE

Hapat	Përshkrimi	Periudha	Kosto dhe burimi i financimit
Përzgjedhja dhe vlerësimi	Hapi i parë është identifikimi i vendeve të trashëgimisë disonante me rëndësi historike, stabilitet ndërtimor dhe aksesueshmëri, duke u mbështetur në anketime, vlerësime nga ekspertë dhe konsultime me historianë. Bashkia mund të përzgjedhë vende të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, që ruajnë ekuilibrin midis trashëgimisë historike dhe nevojave moderne të komunitetit, si dhe të krijojë partneritete me shoqata lokale, shkolla, artistë dhe organizata kulturore për përdorimin e tyre.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Përdorimi i vendeve të trashëgimisë disonante për aktivitete nga Bashkia dhe palët e interesuara.	Pas vlerësimit të përshtatshmërisë së këtyre vendeve, Bashkia do të promovojë aktivisht përdorimin e tyre për aktivitete kulturore, edukuese dhe komunitare, edhe nëse ato nuk lidhen direkt me trashëgiminë disonante, si ekspozita, trajnime, festivale dhe shfaqje. Ndërsa monumenti që përkujton Kongresin e Përmetit, i vendosur në qendër të qytetit, mbetet vend kyç për ngjarje të mëdha, aktivitetet e fundit të organizuara nga shoqata në vende të tjera kanë rritur dukshmërinë dhe kanë nxitur shkëmbimin kulturor.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia e Përmetit + shpenzimet e mbuluara nga projektet e ndryshme.
Krijimi i muzeve dhe pikave të informacionit në vendet e trashëgimisë disonante	Gjithashtu, krijimi i muzeve dhe pikave të informacionit turistik në ose pranë vendeve të trashëgimisë disonante mund t'i kthejë ato në qendra edukuese dhe turistike të aksesueshme. Për shembull, Muzeu i Luftës në Sallën e Kongresit tërheq adhurues të historisë. Atraksione të ngjashme pranë vendeve të tjera mund të rrisin dukshmërinë dhe integrimin kulturor.	2025-2028	Kosto e pikës së informacionit: 900,000 euro Burimi i financimit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Targeti:

Numri i aktiviteteve të organizuara në vendet e trashëgimisë disonante: të paktën 4 çdo vit

Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete: 300 pjesëmarrës në total çdo vit

Numri i vendeve të trashëgimisë disonante të përdorura për krijimin e muzeve, pikave të informacionit etj.: 1 brenda vitit 2028

LOGJIKA E PLANIT

VEPRIMI 10: ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE KULTURORE PËR TRASHËGIMINË DISONANTE.

Hapat	Përshkrimi	Periodha	Kosto dhe burimi i financimit
Planifikimi dhe krijimi i partneriteve	Bashkia e Përmetit ka një grup pune për planifikimin e aktiviteteve kulturore. Aktualisht, i vetmi aktivitet që lidhet me trashëgiminë disonante është përvjetori i Kongresit të Përmetit më 24 Maj, por ULG ka propozuar iniciativa shtesë si ekspozita dhe performanca artistike. Për shkak të buxhetit të kufizuar, do të fokusohemi tek aktivitetet që mund t'i menaxhojë vetë, duke eksploruar partneritete për ngjarje më të mëdha. Ky planifikim zhvillohet gjatë muajve Nëntor, Dhjetor.	Nëntor- Dhjetor të çdo viti	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Zbatimi i aktiviteteve kulturore	Pas finalizimit të një plani të qartë në fazën paraprake, aktivitetet kulturore do të realizohen. Faza e zbatimit do të përqendrohet në organizimin dhe ekzekutimin efektiv të ngjarjeve të planifikuara, duke siguruar që ato të përputhen me objektivat e vendosura për promovimin e trashëgimisë disonante.	Gjatë gjithë vitit	Kosto: 5,000 euro në vit (përfshin shpenzimet logjistike për organizimin e të paktën 3 aktiviteteve) Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit, fonde të donatorëve kombëtarë dhe të huaj.
Monitorim dhe përmirësim	Pas zbatimit të aktiviteteve kulturore, mbledhja e përshtypjeve nga pjesëmarrësit dhe aktorët është thelbësore për të vlerësuar ndikimin dhe për të identifikuar fusha për përmirësim. Njohuritë e fituara do të shfrytëzohen për të përmirësuar kalendarin vjetor kulturor, optimizuar përdorimin e burimeve dhe forcuar partneritetet për iniciativa të ardhshme.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Targeti:

Numri i aktiviteteve të trashëgimisë disonante të përfshira në kalendarin vjetor të Bashkisë: të paktën 3 aktivitete çdo vit.

Numri i aktiviteteve të lidhura me trashëgiminë disonante të organizuara: të paktën 3 aktivitete çdo vit.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet e organizuara: 200 pjesëmarrës në total çdo vit.

IMPLEMENTIMI I PLANIT

Bashkia e Përmetit është përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e veprimeve të parashikuara në Planin e Integruar të Veprimit (IAP). Suksesi i këtij plani bazohet në:

Bashkëpunimi me Partnerët: Bashkëpunimi i mirë me palët e interesuara, veçanërisht me grupet e interesit është i domosdoshëm. Ata janë përfshirë në hartimin e planit dhe do angazhohen dhe në zbatimin dhe monitorimin e veprimeve. Partnerët përfshijnë gjithashtu institucione kulturore, OJQ, artistë, institucione arsimore dhe bizneset lokale.

Tregues të Qartë Monitorimi: Plani përfshin indikatorë të matshëm për çdo veprim specifik.

Analiza e risqeve: Risqet kryesore përfshijnë kundërshtimi i komunitetit, kufizimet financiare, pasaktësitë historike, angazhimin e ulët të publikut dhe sfidat në sigurimin e partneriteteve. Strategjitë për të reduktuar këto risqe janë: përfshirjen e palëve të interesuara, programe informuese, mbledhja e informacionit nga ekspertët, integrim në kurikula dhe monitorim të gjendjes së vendeve.

Fizibiliteti Financiar dhe Burimet e Financimit: Plani është i zbatueshëm financiarisht, duke përdorur resurset e bashkisë, kontributet jofinanciare, burimet njerëzore dhe kapacitetet logjistike ekzistuese. Veprimet përputhen me burimet e mundshme të financimit, duke përfshirë programet e BE-së, ministritë dhe donatorët e huaj, duke siguruar qëndrueshmëri.

Në përgjithësi, plani është realist dhe i projektuar për një zbatim të suksesshëm, duke u mbështetur në monitorim të strukturuar, bashkëpunim me palët e interesuara, menaxhim të risqeve, planifikim financiar dhe aktivitete pilot të testuara, të cilat sigurojnë ndikim dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Për më shumë informacion, konsultoni Planin e Integruar të Veprimit të plotë: <https://bashkiapermet.gov.al/archethics/>